



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.495, datë 21.10.2020

**PËR
KRIJIMIN E NJËSIVE TË SHËRBIMIT LIGJOR
PRANË GJYKATAVE TË APELIT**

Mbështetur në nenin 147/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 61, pika 2/ë, 94 pika 3 dhe 97 pika 1/c të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI

1. Krijimin e “Njësisë së Shërbimit Ligjor” si pjesë e strukturës së gjykatave të apelit, me organikë si më poshtë :
 - a. Gjykata e Apelit Tiranë - 15 ndihmës ligjorë
 - b. Gjykata e Apelit Durrës - 6 ndihmës ligjorë
 - c. Gjykata e Apelit Gjirokastrë - 3 ndihmës ligjorë
 - d. Gjykata e Apelit Korçë - 3 ndihmës ligjorë
 - e. Gjykata e Apelit Shkodër - 5 ndihmës ligjorë
 - f. Gjykata e Apelit Vlorë - 6 ndihmës ligjorë
 - g. Gjykata Administrative e Apelit – 8 ndihmës ligjorë
 - h. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar - 5 ndihmës ligjorë

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR